



SPECIFIKIMET TEKNIKE

**ILLYRIAN GUARD Sh.A**

**“BARRIERË ELEKTRONIKE TRARË”**

## 1. HYRJE

---

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Autoritet Kontraktues : **Illyrian Guard Sh.A**

### 1.2. Historiku

"Illyrian Guard" sh.a është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 4 Prill 2019, si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror, për ofrimin e shërbimeve ndaj personave fizikë e juridikë, publikë dhe privatë. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 % të aksioneve të shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a., është Ministria e Brendshme. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime mbështetëse në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj, në zbatim të kompetencave që i njihen kësaj të fundit sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore. Mënyra e përlogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie, për të përfutur shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike. "Illyrian Guard" vjen si një alternativë e re në treg, duke garantuar profesionalizëm, cilësi maksimale si dhe sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit. Përdorimi i teknologjisë së avancuar dhe infrastruktura kontribuon në ofrimin e një

shërbimi me cilësi të lartë dhe garanton konfidencialitetin e informacionit. Në fokus të Shoqërisë janë gjithashtu kërkimet teknologjike të thelluara në funksion të sigurisë fizike dhe kibernetike.

- **Qëllimi i Illyrian Guard Sh.A është të implementojmë sistemet më të avancuara ndërkombëtare në funksion të ruajtjes dhe të krijojmë partneritet me kompanitë lider në botë.**

## 2. QËLLIMI I PUNËS

### 2.1. Të Përgjithshme

- Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:
  - Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” ;
  - Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”
  - VKM Nr.177, datë 04.04.2019 “ Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SH.A”
  - VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.
- Të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale në respekt të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në veçanti të Nenit 27 “Masat e sigurisë për të dhënat personale” dhe Nenit 28 “Konfidencialiteti i të dhënave” të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## ❖ KËRKESAT FUNKSIONALE


1. Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë instalimin dhe konfigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për këtë projekt.
  - Përsa i përket konfigurimeve është detyrë e operatorit ekonomik fitues kryerja e të gjitha konfigurimeve të nevojshme përsa i përket:
    - a. Konfigurimet e Pulteve të Trarëve, Butonave të Trarëve dhe Tripodeve.
2. Garancia e ofruar për pajisjet fizike do të jetë sipas modelit të secilës pajisje, të përcaktuar më poshtë në specifikimet teknike.
3. **Çdo pajisje dhe material poshtë përmendura duhet të jetë FV “Furnizim Vendosje”.**
4. Ofertuesi i shërbimit në rast se nevojitet të jetë i gatshëm për zhvendosjen fizike të produkteve të kërkuara nga AK si në listën e mëposhtme, brenda afatit të kontratës, kur kjo kërkohet nga Illyrian Guard Sh.A në një masë jo më tepër se 30 % të Produkteve të instaluar. Realizimi i zhvendosjes duhet kryer në afat kohor jo më shumë se 7 ditë kalendarike nga dita e njoftim zyrtar duke mos ndikuar në aktivitetin e Illyrian Guard Sh.A.
5. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër që Trarët të disponojnë opsionet që të konektohen me Akses Kontrolle/Kamera përshembull: dalje Input/Output/ Lock output ose terma të tjerë.
6. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër që Tripodet të kenë opsionet për tu konektuar me Akses Kontrolle me Card/Face/Finger përshembull: dalje Input/Output/ Lock output ose terma të tjerë.

➤ **Lista e Pajisjeve Elektronike F.V dhe Lista me materialet që janë të nevojshme në instalimin e tyre .**

Numrat e renditur sipas specifikimeve më poshtë	Emertimet
1.	Tra Parkimi
2.	Tripodë
3.	Kufizues anësorë për Tripode
4.	Suport Metalik 160cm
5.	Sensorë për trarët
6.	Buton Për Tripodet dhe Trarët
7.	Pulte për trarët
8.	Kabull Elektrik 3x2.5
9.	Tub Fleksibël 25 Ø
10.	Tub Rigid (i ngurte) 20 Ø bashkë me aksesorët
11.	Hapje Kanali, Betonizim.


➤ **Specifikimet Teknike për Pajisjet Elektronike dhe Materialet të nevojshme për instalimin sipas listës të dhënë më sipër.**

**1. Tra Parkimi**

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Power supply	220 VAC ± 15%
Kontrolli “Controller”	Ngritja / Rënia / Ndalimi “Rise/Fall/Stop”
Temperatura e Operimit	<b>Min.</b> -20°C dhe +60°C
Niveli i Mbrojtjes	IP54
Materiali	SECC
Trashësia e Strehimit	<b>Min.</b> 2.0 mm
Trashësia e Derës	<b>Min.</b> 1.0 mm
Konsumi	300W ose më pakë
Shpejtësia e Ngritjes	<b>Min.</b> 2 sekonda ose më shpejt
Shpejtësia e Uljes	<b>Min.</b> 4 sekonda ose më shpejt
Gjatësia e Barrieres	<b>Min.</b> 2.7 metër
Opsione	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbyllje automatike edhe kur ndërpritet rryma, Trau “Barriera” duhe të përdoret edhe me energji të ndërprer (Manualisht) për ta mbajtur atë në funksion</li> <li>Shpejtësia në rritje dhe në rënie duhet të rregullohet në mënyrë të pavarur.</li> </ul>
Garancia	2 vjet
 Parametra me te mira dhe opsionet shtesë	<input checked="" type="checkbox"/> Pranoen

**2. Tripod**

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Power Supply	100 to 240 VAC
Temperatura e Operimit	-10 °C dhe +40 °C ose më mirë
Mjedisi i Instalimit	Indoor ose më mirë
Korsi dydrejtimëshe	Hyrje/Dalje
Niveli i Mbrojtjes	IP54

Materiali	Inoks ose më mirë
Input	<b>Min.</b> 2
Output	<b>Min.</b> 2
Lock output	<b>Min.</b> 2
Të Suportoj	Card/Face/Fingerprint
Tregues LED	I hyrjeve dhe daljeve
Opsione	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në rast alarm zjarri barriera duhet të hapet automatikisht në rastet urgjente të evakuimit.</li> <li>Sistemi duhet ta anullojë kalimin nëse një person nuk kalon nëpër korsi brenda kohëzgjatjes së vlefshme të kalimit.</li> </ul>
Miratimi	CE/FCC/CB/ROHS/REACH/WEEE
Garancia	2 vjet
 Parametra me te mira dhe opsionet shitesë	✓ Pranohen

### 3. Kufizues anësorë për Tripode

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Parametrat	<b>Min.</b> 1200mm “nga e majta në të djatht” x <b>Min.</b> 950 mm “Lartësia” ( L x H )
Materiali	Xham Akrilik “Acrylic”

### 4. Suport Metalik 160cm

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Dimesioni	10x10x10x10 me pllak Katrore në pjesën fundore që të mundësoj kapjen në Beton me Vida.
Gjatësia	160 cm
Streha	Po,Suporti metalik duhet të jetë me Streh në pjesën e sipërme të tij ku të mbroj paisjet që ka AK nga reshjet e shiut. <ul style="list-style-type: none"> <li>Dimensioni i Paisjes që ka aktualisht AK është (L x W x H) 205 mm x 76.5 mm x 37 mm (8.07" x 3.01" x 1.46" ) .</li> </ul>

### 5. Sensorë për trarët

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Tipi	Sensori Duhet të suportohet nga trarët, në rastet kur kalon automieti trau mos të mbyllet kur automieti e ka bllokuar rrezen e Sensorit Trau duhet të rrijë i hapur në rastet kur nevoitet bazament për kapjen e sensorit OE duhet ta ofroje atë.
Garancia	2 vjet

### 6. Buton për Tripode dhe Trarë

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
Tipi	Butoni Duhet të Suportohet nga trarër dhe Tripodet në rastet kur nevoitet për ta hapur me buton atë nga punonjësi i Shërbimit ose Receptionsioni.